



Deklaratë për shtyp - 594/07/2020

Nordrhein-Westfalen zgjat Urdhëresën për Mbrojtjen nga Koronavirusi : Implementimi i një mase frenuese lokale ndaj koronavirusit dhe rregulla të qarta për shkolla dhe evenimente

31.08.2020
Faqja 1 nga 6
Pressestelle Staatskanzlei
40213 Düsseldorf

Telefon 0211 837-1134
0211 837-1405 ose
0211 837-1151

presse@stk.nrw.de
www.land.nrw

**Ndalohen evenimentet e mëdha deri në 31 Dhjetor 2020 / Përfundon në 1 Shtator 2020 detyrimi për të mbajtur maska në klasë
Ministria e Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe
Ministria e Shkollës dhe Arsimit ju komunikojnë:**

Në 27 Gusht 2020, NRW implementon rregulloret dhe masat tek Urdhëresa e përshtatur në lidhje me Mbrojtjen nga Koronavirusi (CoronaSchVO), me qëllim uljen e incidencës së infeksionit në përputhje me vendimet e Landeve dhe të qeverisë federale. Në të njëjtën kohë, rregulloret në lidhje me koronavirusin do të zgjaten deri në 15 Shtator. Rregulla të reja vlejné në lidhje me aprovimin e evenimenteve dhe shkollave duke filluar nga data 1 Shtator 2020, së bashku me implementimin e një mase frenuese në nivel lokal për koronavirusin, në mënyrë që të përgjigjemi më shpejt dhe më përshtatshëm ndaj një rritje të incidencës në nivel lokal në komunat e afektuara. Si rrjedhim, do të zgjaten rregulloret për mbajtjen e detyruar të maskave në hapësirat e shkollave. Duke patur parasysh ecurinë e incidencës së infeksionit, do të përfundojë gjithashtu siç është shpallur më 31 Gusht 2020 detyrimi paraprak për të mbajtur një maskë për mbulimin e gojës dhe të hundës gjatë qëndrimit në klasë në shkollat e arsimit të mesëm të ulët, gjimnazet dhe shkollat profesionale .

Me aktualizimin e Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi, Landi ka përfshirë rregullore për një masë lokale në lidhje me frenimin e koronavirusit. Si rrjedhim do të zbatohet në të ardhmen rregullorja e mëtejshme: Nëse incidenca e 7 ditëve në një rreth ose qytet të pavarur kalon shifrën 35, komunat e afektuara, Qendra e Shëndetësisë e Landit të Nordrhein-Westfalen dhe qeveria përgjegjëse e qarkut duhet të koordinojnë dhe implementojnë masa të tjera mbrojtje të posaçme për të frenuar incidencën e infeksionit. Kjo duhet të jetë një përgjigje fillestare ndaj incidencës lokale të infeksionit. Kur incidenca e 7 ditëve të arrijë shifrën 50, do të procedohet me një hap tjetër. Pastaj duhen miratuar dhe implementuar masa të reja me pjesëmarrjen e Ministrisë së Shëndetësisë.

Me zgjatjen e Urdhëresës për Mbrojtjen nga Koronavirusi, qeveria e Landit riorganizon gjithashtu procedurën e aprovimit për evenimente. Është e qartë se për evenimente me më shumë se 500 pjesëmarrës, organizuesi përveç planit të mbrojtjes dhe të higjienës duhet të sigurojë gjithashtu një ardhje dhe ikje të pjesëmarrësve të përshtatshme për pandeminë. Duhet të dorëzohen gjithashtu tek Landi plane për evenimente me mbi 1000 pjesëmarrës pasi plani për higjienën është ekzaminuar dhe aprovuar nga komuna. Ministria e Punës, Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale mund të japë aprovimin e saj ose jo nëse zhvillimi i një eventit të tillë madhor nuk është i pajtueshëm me qëllimin e reduktimit të infeksionit, duke u bazuar tek incidenca e infeksionit përgjatë Landit. Evenimentet qëndrojnë të ndaluara deri në 31 Dhjetor 2020.

Ministri i Shëndetësisë Karl-Josef Laumann: „Zhvillimi dinamik i rasteve të infeksionit i javëve të fundit ka treguar se duhet të qëndrojmë vigjilentë. Si rrjedhim, kemi krijuar një mekanizëm në mënyrë që të përgjigjemi herët ndaj rritjeve të numrit të infeksioneve në nivel komunal. Për më tepër, Landi tani ka gjithashtu opsionin për të ndaluar evenimente me më shumë se 1000 pjesëmarrës nëse incidenca kombëtare e infeksioneve nuk i lejon evenimente të tilla. Qëllimi jonë i qartë është që të fenojmë virusin në fazat e para dhe si rrjedhim të parandalojmë mbylljen e qendrave të kujdesit ditor për fëmijë dhe të shkollave si dhe një kufizim të jetës publike. Kjo është një arsye tjetër pse dua t'u bëj sërish apel të gjithë qytetarëve dhe qytetareve: Ju lutem vazhdoni të ndiqni me përgjegjësi udhëzimet dhe rregullat ekzistente.“

Në përgjithësi urdhëresa e përshtatur nuk shënon hapje të reja të rëndësishme, duke marrë në konsideratë incidencën e infeksionit. Mesazhi i qartë vazhdon të jetë që ne duhet t'i bindemi rregulloreve të tanishme. Si rrjedhim do të zbatohet në akordim me Landet e tjera dhe qeverinë federale gjoha minimale prej 50 eurosh në rastin e shkeljes së detyrimit për mbajtjen e një maske për hundën dhe gojën. Një shkelje e tillë në transportin publik në Nordrhein-Westfalen do të ndëshkohet me një gjobë prej 150 Eurosh.

Do të zgjerohet gjithashtu deri në 15 Shtator Urdhëresa për Kujdesin ndaj Koronavirusit (CoronaBetrVO) e cila përmban udhëzimet për shkollat dhe për qendrat e kujdesit ditor për fëmijë.

Rregulloret për detyrimin bazë për mbajtjen e maskave në ndërtesat e shkollave dhe në mjediset e shkollave do të vazhdojnë të jenë të vlefshme por nuk vlen më detyrimi për të mbajtur një maskë e cila mbulon gojën dhe hundën gjatë mësimit në klasë. Ky hap bëhet i mundur nga ecuria e incidencës së infeksionit në Nordrhein-Westfalen dhe eksperiencat pozitive deri tani në shkolla. Plani i mbrojtjes për shkollat mbështetet në tre shtylla: Planet e higjienës, gjurmueshmëria e kualifikuar dhe mbrojtje e gojës dhe e hundës. Këto tre shtylla vazhdojnë të qëndrojnë.

Ministrja e Shkollës dhe Arsimit Yvonne Gebauer: „ Detyrimi i mbajtjes së maskës në klasë në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë është implementuar pas pushimeve të verës në kohë të pasigurta kur incidenca e infeksionit ishte vazhdimisht në rritje. Ajo ishte e limituar që nga fillimi në pikën kohore kur mund të bëhej një vlerësim i besueshëm i incidencës pas sezonit të pushimeve pra 2 javë pas mbarimit të pushimeve. Pas pothuajse tre javësh që nga fillimi me sukses i shkollës, shifrat e infeksionit në Nordrhein-Westfalen kanë patur zhvillime pozitive, prandaj mund ta anulojmë detyrimin e mbajtjes së maskës në klasë gjatë mësimit. Maska duhet të mbahet tashmë vetëm kur nxënësit largohen nga banka. Ky është një lehtësim i ndjeshëm. Por ne qëndrojmë vigjilentë dhe shkëmbejmë vazhdimisht informacione me personat e përfshirë në rregulloret e shkollave dhe me vetë shkollat. Në të njëjtën kohë ne zbatojmë vazhdimisht higjienën strikte dhe masat për mbrojtjen nga infeksioni në shkollat tona në mënyrë që të vazhdojmë të mundësojmë mbrojtjen më të mirë të mundshme për të gjithë në jetën shkollore. Plani jonë për një veprimtari të përshtatur shkollore në kohët e koronës po jep efekt dhe po ofron mundësi për t'u përgjigjur siç duhet ndaj ecurisë së incidencës së infeksionit.”

Shkollat mund të bien dakord me organet përgjegjëse dhe drejtuese për të vazhduar me mbajtjen vullnetarisht të një maske për gojën dhe për hundën në klasë.

Rregulloret vazhdojnë të qëndrojnë momentalisht të pandryshuara Për sa i përket Urdhëresës së Udhëtimeve Hyrëse, në lidhje me koronavirusin. Gjithsesi, detyrimi për t'u testuar dhe procedura e raportimit rezultojnë direkt nga udhëzimet e Ministrisë Federale të Shëndetësisë.

Nuk priten ndryshime deri në mesin e shtatorit. Deri atëherë Landi do të përshtasë rregulloret e tij vetëm në lidhje me udhëtarët në kufij dhe me përmbushjen e detyrimit të raportimit nëpërmjet plotësimit të ashtuquajturave "Aussteigerkarten".

Përmbledhje e ndryshimeve më të rëndësishme:

Sanksionimi ligjor i monitorimit të incidencës së infeksionit (më e reja § 15a)

- Është sanksionuar me ligj që autoritetet shëndetësore me mbështetje nga Qendra e Landit për Shëndetësinë e Nordrhein-Westfalen (LZG) të monitorojnë vazhdimisht numrin e infeksioneve në nivel lokal, rajonal dhe në të gjithë Landin, duke patur parasysh se incidenca e 7 ditëve është një tregues kryesor. Sapo incidenca e 7 ditëve në një rreth ose në një qytet të pavarur të kalojë 35, komunat e afektuara, Qendra e Shëndetësisë e Landit të Nordrhein-Westfalen dhe qeveria përkatëse e qarkut duhet të koordinojnë dhe të implementojnë menjëherë masa të tjera konkrete mbrojtëse për të vënë nën kontroll incidencën e infeksionit. Nëse numri i infeksioneve nuk i atribuohet dot mjediseve të caktuara ose vendndodhjeve të ngjashme dhe nuk limitohet dot, mund të urdhërohen masa mbrojtëse të cilat janë përtej fushëveprimit të kësaj urdhërese.
- Duke filluar nga një incidencë 7 ditore prej 50, janë të detyrueshme masa shtesë mbrojtëse. Në këto raste duhet të përfshihet në konsultime Ministria e Shëndetësisë.

Udhëzimet në lidhje me evenimentet (Ndryshime tek §§ 2b)

- Krahas kërkesave të specifikuara më përpara, plani i higjienës dhe i mbrojtjes nga infeksioni **për eventime me më shumë se 500 pjesëmarrës** duhet të shpjegojë gjithashtu si do të zhvillohet ardhja dhe ikja e personave në përputhje me kërkesat për mbrojtjen nga infeksioni.
- Plani duhet të shpjegojë si më përpara si do të përmbushet kushti i distancës minimale prej 1.5 metrash dhe se si do të garantohet higjiena e veçantë kundër infeksionit (nëpërmjet intervaleve të posaçme të pastrimit, opsioneve të vazhdueshme për dezinfektimin e duarve, tabelave informuese se si të sillemi në mënyrën e duhur për t'u mbrojtur nga koronavirusi, etj).

- Një tipar i ri është gjithashtu fakti se për evenimente me më shumë se 1000 pjesëmarrës, komunat duhet të marrin aprovimin e Ministrisë së Shëndetësisë para pajisjes me lejen. Kjo do të thotë se autoritetet lokale e njoftojnë Ministrinë e Shëndetësisë për evenimente për të cilat ata besojnë se plani për mbrojtjen nga infeksioni dhe i higjienës janë në rregull, në mënyrë që evenimenti të aprovohet si normalisht. Ministria e Shëndetësisë mund të refuzojë të japë aprovimin e saj, nëse zhvillimi i një evenimenti të tillë nuk përputhet me qëllimin e vënies nën kontroll të shkallës së infektimit për shkak të numrit të pjesëmarrësve, pavarësisht një plani higjiene i cili është vlerësuar pozitivisht nga autoritetet lokale duke u bazuar tek rëndësia kombëtare e shkallës së përhapjes së infeksionit me qëllim uljen e rasteve të infeksionit. Ministria e Shëndetësisë mund të tërheqë një aprovim të dhënë më përpara në çdo moment, nëse rritet numri i rasteve të infektuara ose arsye të tjera nuk e justifikojnë zhvillimin e evenimenteve.
- Këto rregullore vlejnë për të gjitha evenimentet, të cilat do të zënë vend duke filluar nga data 12 Shtator 2020, në mënyrë që t'u jepet mundësia autoriteteve të ndryshojnë procedurën..
- Evenimentet e mëdha do të qëndrojnë kryesisht të ndaluara deri në 31 dhjetor. Përkufizimi "Eveniment madhor" nuk i referohet numrit të stafit por rëndësisë së infeksionit për sa i përket evenimentit (festivalet e qitjes, panairët e rrugës, festivalet e muzikës, etj.). Ministria e Shëndetit po mban bisedime në lidhje me tregjet e Krishtlindjeve duke u bazuar tek planet e higjienës të dorezuara për këtë gjë.

Ekskursionet dhe festat e kompanive

- Rregullat për festat e kompanive dhe ekskursionet të cilat kanë qenë të ndaluara deri tani, do të jenë në përputhje me sektorin privat. Në të ardhmen, takimet, mbledhjet dhe evenimentet në kompani , biznese dhe autoritete zyrtare, të cilat mbahen për arsye socialo-komunikuese do të lejohen nën të njëjtat udhëzime dhe kufizime të cilat vlejnë për sektorin privat.

Urdhëresa për kujdesin ndaj koronavirusit

- Maskat janë akoma të detyrueshme në ndërtesat e shkollave dhe në të gjitha hapësirat e shkollave. Detyrimi për të mbajtur një maskë nga klasa e pestë e më lart i cili është i vlefshëm deri në 31 gusht 2020 do të hiqet për rastin e qëndrimit në karrige.
- Ekziston një plan në lidhje me vendet e uljes në bankë në klasë për të garantuar gjurmueshmërinë.

Urdhëresat përkatëse do të postohen gjatë ditës tek www.land.nrw.

Nëse keni pyetje civile ju lutemi kontaktoni [Qendrën e shërbimeve](#) të qeverisë së Landit, Telefon 0211 837-1001.

Nëse keni pyetje, ju lutem kontaktoni zyrën e shtypit të Ministrisë së Punës, Shëndetësisë dhe të Çështjeve Sociale, Telefon 0211 855-3118, ose zyrën e shtypit të Ministrisë së Shkollës dhe Arsimit, Telefon 0211 5867-3505.

Kjo deklaratë për shtyp është gjithashtu në dispozicion në internet në adresën e internetit të qeverisë së Landit www.land.nrw

[Informacion i përgjithshëm për mbrojtjen e të dhënave në rrjetet sociale](#)